

Thirrja është e hapur nga data 01.07.2026 deri me 05.07.2026

TERMAT E REFERENCËS

HOTELE/ RESTAURANTE NË KOMUNËN E PEJËS TË CILËT OFROJNË SHËRBIME PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE TË ORGANIZATËS NEVO KONCEPTI

Organizata	OJQ "NEVO KONCEPTI"
Objektiva	Përzgjedhja e hotelit/restaurantit në Komunën e Pejës për zhvillimin e aktiviteteve të organizuar nga OJQ "Nevo Koncepti".

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmije, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

2. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Mirëpritja e stafit dhe antarëve të cilët do të marrin pjesë në aktivitetin të cilin do të zhvillohet në Restuarant.
- Përgaditja e ushqimit sipas kërkesës, nga ana përfaqësuesve të OJQ "Nevo Konceptit".
- Salla e takimeve të plotësojë kushtet për zhvillimin e takimeve, trajnimeve dhe konferencave.
- Përgatitja e faturës me kohe dhe pritshmëria e pagesës përmes transferit bankar.
- Zbritja e TVSH-së në faturim bazuar në dokumentin e ofruar nga OJQ "Nevo Koncepti" e cila lirohet nga TVSH-ja në bazë të UA Nr.03/2015 për TVSH

3. AFATI KOHOR

Njoftimi i përfaqësuesve të restaurantit/hotelit për zhvillimin e aktiviteteve të caktuara do të jetë dy ditë më parë para zhvillimit të aktivitetit për shkak të përgaditjes.

5. REZULTATET E PRITSHME

- Bashkëpunim të mirëfilltë.
- Ushqimi dhe pijet të jenë me çmime të njëjta gjatë periudhës së kontratës.
- Ushqimi dhe pijet të jenë kualitative.
- Përgatitja e ushqimit me kohë dhe i freskët.
- Salla e Konferencave të ketë kushtet të cilat i përmbushë për mbajtjen e aktivitetit.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- Kërkesa për ofertë (të jetë e nënshkruar dhe e vulosur)
- Oferta (të jetë e nënshkruar dhe e vulosur)
- Kopja e dokumentit të ARBK-së së biznesit.

Aplikimi duhet të dërgohet jo më larg se data 05.07.2026 në emailin: prokurimi@nevokoncepti.org apo në formë fizike në selinë e OJQ "Nevo Koncepti" në adresën Rr. Adnan Krasniqi nr.149, hyrja II Nr.8 Prizren.